

Vauçerë me vlerë për pensionistët me pension të ulët

Shoqata e pensionistëve - Tetovë, me vendim të Këshillit Ekzekutiv, në prag të festave të Bajramit dhe Pashkëve, ndau mjete financiare nga buxheti i saj për t'u ndihmuar pensionistëve anëtarë të Shoqatës me të ardhura të ulta. Komisioni i formuar për këtë aktivitet pensional, në bashkëpunim me degët vendore, gjatë muajit mars të këtij viti mblodhi dokumentet e nevojshme për konstatimin e gjendjes faktike. Këtë herë Komisioni vlerësoi se për këtë aktivitet mund të aplikojnë të gjithë pensionistët që nuk marrin pension më të lartë se 18.500 den. Kryetarët e degëve kanë vepruar sipas Vendimit të KE-së dhe kanë përpiluar listat e pensionistëve (23 nga secila degë), të cilat i kanë dorëzuar në selinë e SHP Tetovë.

Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të ndihmës në formë të vauçerit në vlerë prej 2.000 denarë ishte 506 pensionistë. Në përzgjedhjen e emrave të përfituesve të kësaj ndihme, Komisioni, ndër të tjera, ka marrë parasysh listat e paraqitura nga degët, pasi janë bordet e degëve ato që njohin më së miri anëtarësinë dhe gjendjen e tyre sociale. Kjo ndihmë është e mirëseardhur për pensionistët me pensione të ulëta, aq më tepër që jepet në prag të festave fetare të Pashkëve dhe të Bajramit. (M. Murseli)

BISEDË ME KRYETARIN E KËSHILLIT EKZEKUTIV TË SHP-ÇAIR, RAUF HAMIDI

RRITJA E AKTIVITETEVE TË PENSIONISTËVE

Kryetari i Kuvendit të SHP Çair, Rauf Hamidi, është zgjedhur kryetar i Këshillit ekzekutiv të shoqatës në zgjedhjet e rregullta të marsit 2023. Me këtë kanë vazhduar aktivitetet e pensionistëve në vazhdimësi, me Hamidin, me angazhimin e tij, duke u përfshirë plotësisht dhe aktivisht në të gjitha ngjarjet që ishin organizuar deri atëherë. "Fillimisht, më lejoni të them se besimi që më është dhënë është nder, përgjegjësi dhe obligim i madh për mua që të udhëheq një shoqatë multietnike. Kjo shoqatë multietnike mund të shërbejë si shembull për shoqatat e tjera për bashkëjetesë të pensionistëve. Angazhimi dhe përkushtimi në punën që kanë aplikuar kryetarët para meje janë udhërrëfyes që unë të angazhohem me gjithë kapacitetin dhe përvojën time dhe t'i kryej aktivitetet nga Programi i punës, degët dhe organet e shoqatës, në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme", theksoi kryetari i SHP Çair, Hamidi.

Edhe pse Rauf Hamidi zyrtarisht doli në pension në vitin 2005, aktiviteti i tij vazhdon si pensionist. Është emëruar nga drejtori i atëherëshëm i SPIM-it, Bekim Neziri, koordinator për shtëpitë e të moshuarve, e më pas për shtatë vite ka qenë menaxher i Shtëpisë së të moshuarve "Lika Çopova" në Fushën e Topanës. Ai është aktivist i afirmuar dhe është zgjedhur anëtar i KE të SHP Çair, dhe pas katër vitesh kryetar i Kuvendit të shoqatës. Rauf Hamidi, si aktivist i vjetër, është plotësisht i njohur me nevojat dhe jetën e popullatës më të vjetër në SHP Çair. "Aktivitetet e përshkruara në Programin tonë 2025 janë vërtet të shumta dhe do të zbatohen përmes të gjitha formave të organizuara të veprimit. Kujdesi për përmirësimin e kushteve të jetesës së përfituesve të pensionit është detyrë prioritare e shoqatës, me qëllim krijimin e kushteve për një jetë dinjitoze, duke

hapur klube për pensionistët, ku ata të kalojnë kohën e lirë, si dhe duke realizuar aktivitete të caktuara. Në territorin e Komunës së Çairit funksionojnë dy klube të pensionistëve, falë bashkëpunimit të shkëlqyer me Komunën e Çairit, e cila na ndihmon në të gjitha aktivitetet e shoqatës, duke demonstruar kështu kujdesin e nevojshëm ndaj kësaj kategorie qytetarësh, me qëllimin përfundimtar që t'u mundësohet një jetë sa më komode. Edhe Aktiviti i pensionistëve gjithashtu punon në mënyrë aktive dhe të suksesshme me Shoqatën e Pensionistëve, veçanërisht në fushën kulturore dhe humanitare", tha kryetari i SHP Çair, Hamidi.

Ai foli edhe lidhur me aktivitetet kulturore, argëtuese dhe sportive të pensionistëve në SHP Çair. "Shoqata merr pjesë aktive në të gjitha manifestimet kulturore dhe sportive. Pres pjesëmarrje më të suksesshme dhe masive këtë vit në lojërat sportive rajonale dhe republikane. Për këtë, Komisioni i Sportit do të përgatisë një plan dhe do të angazhohet në formimin e ekipeve në fusha të caktuara të sportit dhe do të punojë në përgatitjen e sportistëve në pension për pjesëmarrje në lojërat sportive rajonale dhe republikane të organizuara nga LSHPM dhe për arritjen e rezultateve sa më të mira. Deri tani e kemi dëshmuar veten si ruajtës të vërtetë të traditës së pasurisë sonë kulturore. Gjithashtu do të bëjmë përpjekje për të ruajtur vlerësimin e Kryesisë së pensionistëve në shfaqjet folklorike, për të cilat Komisioni do të përgatisë një program për përgatitjen dhe performancën e shfaqjeve rajonale dhe republikane për vitin 2025, për realizimin në kohë të aktiviteteve ku do të performojmë me grupin e këngës, si gjithmonë, me këngë origjinale maqedonase dhe shqipe, me instrumente origjinale dhe një ngjyrë të pasur të kostumeve", thotë Hamidi.



Bashkëbiseduesi foli edhe për rëndësinë e aktiviteteve të pensionistëve në punën e shoqatës. "Veprimtaria e pensionistëve në shoqatën tonë shquhet për humanizëm. Për anëtarët humanë të Aktivit nuk nevojitet një festë apo ndonjë ngjarje tjetër për të organizuar një aksion humanitar. Humanizmi i tyre është i pranishëm çdo ditë, duke ndihmuar anëtarët e tyre sipas aftësive të tyre. Në Programin e Punës së Aktivit fokusi është i shprehur në aktivitetet sociale dhe humanitare, gjë që thekson rëndësinë e veprimit në këtë fushë. Veçanërisht në fund dua të theksoj se shoqata jonë ofron ndihmë financiare për çdo fëmijë pa prindër dhe përkujdesje prindërore deri në moshën 15 vjeçare dhe ata kujdesen dhe jetojnë me gjyshërit e tyre pensionistë, të cilët u ofrojnë një shtëpi të ngrohtë. Falë këtyre njerëzve, këta fëmijë kujdesen në sistemin e komunës, pra të shtetit. Kjo do të thotë se të gjitha aktivitetet e shoqatës janë të përqendruara në pensionistët dhe nevojat e tyre dhe ne jemi zgjedhur që të kontribuojmë për një jetë më të denjë të pensionistëve, për çka po na drejton edhe përkrahja e Lidhjes të Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë", tha Hamidi. (V. Paçemski)

BISEDË ME MERITA ABAZIN

KORDA TË PLOTËSUARA JETËSORE DHE KRIJUESE



"Shumë njerëz i frikësohen ditëve të pensionit, por për mua nuk është kështu", thotë profesoresha dhe shkrimtarja në pension Merita Abazi. Ajo ka lindur më 6 mars të vitit 1955 në Tetovë. Shkolën fillore dhe të mesme e kreu në Tetovë, ndërsa Fakultetin Filologjik, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në Shkup. Ajo u punësua në vitin 1980 si profesoreshë e gjuhës shqipe në gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup, ku e kaloi gjithë jetën e saj të punës, duke u pensionuar në mars të vitit 2020, por duke ruajtur entuziazmin e saj për të lexuar, krijuar dhe punuar. Është një gjyshe e lumtur që tregon përralla dhe ndoshta përralla më e bukur është jeta dhe kordat e saj krijuese. Vepra e Merita Abazit

shtrihet në faqet e 7 librave me prozë dhe poezi, ku poezitë e saj do të shërbejnë si pasqyrë për atë që dini, duke i dhënë ngjyra dhe kupime të reja letërsisë.

Vitet e fundit kanë qenë vite të sukseseve të saj në fushën e krijimit të letrare në poezi dhe prozë. Merita ka filluar të shkruajë poezi dhe prozë që në gjimnaz dhe pasi doli në pension vendosi të botojë veprat e saj letrare. Fillimisht, ajo hapi kanalën e saj në YouTube me titull "Rrëfimet e gjyshe" duke u fokusuar tek përzgjedhja dhe përkthimi, duke i përgatitur ato vazhdimisht në gjuhën e sotme standarde shqipe dhe duke treguar përrallat, legjendat, mitet dhe historitë më të bukura. Në vitin 2022, ajo botoi përmbledhjen e saj

të parë me poezi, "Imagjinata e endacakes". Ajo vazhdoi veprimtarinë e saj në poezi dhe prozë. Kujtimet e saj të dyta në prozë, "Nëpër stinët e kohës", janë një përmbledhje kujtimesh nga fëmijëria, rinia dhe moshja e rritur, në të cilat ajo përshkruan në mënyrë shumë të mirë jetën e asaj kohe, botuar në vitin 2023.

"Dashurinë ja fala pranverës" titullohet libri i saj i tretë me poezi, i botuar në vitin 2024. Libri me tregime dhe novela "Rrëfime të hidhura e krenare" është botuar në vitin 2024, ndërsa botimi është financuar nga Komuna e Çairit. Merita është autore edhe e përmbledhjes me poezi të shkruar në dy gjuhë, maqedonisht dhe shqip, "Qëndroni në vatër".



"Viti i kaluar ishte vërtet një vit i mbushur me evente, promovime të veprave të ndryshme nëpër institucione dhe portale kulturore, të cilat gjithmonë publikonin shkrimet e mia dhe më inkurajonin të shkruaj edhe më shumë", theksoi Merita.

Në bisedën e pashtershme ajo theksoi se e do qytetin e Shkupit ku jeton, i pëlqen të shoqërohet me njerëz, por gjithsesi më së miri ndihet në shtëpinë e familjes së saj, ku frymëzohet pikërisht aty, më së shumti nga heshtja, am-

bienti dhe pamja.

Ajo botoi disa krijime të saj në botime vendase dhe të huaja dhe puna e saj u vlerësua në atë masë. Talenti i pamatshëm dhe jeta e saj jashtëzakonisht e frytshme burojnë nga faqet e veprave të saj dhe leximet e saj, me gjithë modestinë e rrëfimit, mund të lexohen e rri lexohen me një frymë. Ajo është një shembull për shumë pensionistë se si të përballen me sfidat, si të përmbushin kohën e tyre dhe të jetojnë në mënyrë aktive. (V. Paçemski)